



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTRI

Nr. 5204 prot.

Tiranë, më 16.10.2020

URDHËR

Nr. 424, datë 16.10.2020

PËR

**“PËRCAKTIMIN E FORMËS DHE PËRMBAJTJES SË CERTIFIKATËS SË CILËSISË
PËR PËRPUTHSHMËRINË E PRODUKTIT BUJQËSOR OSE USHQIMOR ME
SPECIFIKIMET TEKNIKE TË PRODUKTEVE TË REGJISTRUARA”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 26, të Ligjit nr. 8/2019, datë 26.2.2019 “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”, me propozim të Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural,

URDHËROJ:

1. Përcaktimin e formatit dhe përmbajtjes së Certifikatës së Cilësisë, për përputhshmërinë e produktit bujqësor ose ushqimor me specifikimet teknike të produkteve të regjistruara si Specialitet Tradicional i Garantuar (STG), Tregues Gjeografik i Mbrojtur (TGJM) dhe Emërtim Origjine i Mbrojtur (EOM), sipas Aneksit 1, bashkëlidhur.
2. Termat (përmbajtja) e përdorur në Certifikatën e Cilësisë, kanë kuptimin si më poshtë:
 - a. emri dhe mbiemri i operatorit të prodhimit;
 - b. adresa e operatorit të prodhimit;
 - c. emri i produktit bujqësor ose ushqimor;
 - ç. kategoria e produktit bujqësor ose ushqimor

do të jenë të njëjtë me të dhënat e deklaruara nga aplikanti në formatin e aplikimit të produktit bujqësor ose ushqimor;

d. sasia e prodhimit e deklaruar nga operatori ushqimor gjatë periudhës së vlefshmërisë së certifikatës, do të jetë sasia e prodhimit që operatori ka gjendje për treg, në momentin e kryerjes së kontrollit zyrtar;

dh. periudha e vlefshmërisë së certifikatës, do të jetë vjetore bazuar në kontrollet zyrtare sipas analizës së riskut.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU).

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.





CERTIFIKATË CILËSIE

Konfirmohet përputhshmëria e procesit të prodhimit të produkteve bujqësore ose ushqimore me specifikimet teknike

Emri dhe mbiemri i operatorit të prodhimit:	
Adresa e operatorit të prodhimit:	
Emri i produktit bujqësor ose ushqimor:	
Kategoria e produktit bujqësor ose ushqimor:	
Sasia e prodhimit e deklaruar nga operatori ushqimor gjatë periudhës së vlefshmërisë së certifikatës:	
Periudha e vlefshmërisë së certifikatës:	

Bazuar në rezultatet e kontrollit të përputhshmërisë së prodhimit të produktit bujqësor ose ushqimor, me specifikimet teknike të përcaktuara në regjistër, referuar nenit 15, të Ligjit nr. 8/2019, datë 26 shkurt 2019, "Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore",

Konfirmohet që:

Produkti _____ është

**SPECIALITET TRADICIONAL / TREGUES GJEOGRAFIK / EMËRTIM ORIGJINE
I GARANTUAR I MBROJTUR I MBROJTUR**

